



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DATË/A:	26.07.2021
REFERENC-Ë:	01-060/01-0050429/21-02
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës së Mitrovicës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Agim Bahtiri – Kryetar i Komunës Znj. Aida Doli Ferati - Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit dhe Pyjeve
NGA/OD/FROM:	z. Irfan Peci – Zyrtar përgjegjës për diskutimin publik për “Planin Lokal të Veprimit në Mjedis”
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport – Procesi i diskutimit publik të “Planit Lokal të Veprimit në Mjedis”

I nderuar,

Duke u bazuar në nenin 12, 58 pika (h), dhe nenin 68, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neneve 23, 48 pika (m) të Statutit të Komunës së Mitrovicës, Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna, të Ministrisë së Pushtetit Lokal, gjegjësisht Komuna e Mitrovicës ka organizuar mbajtjen e dëgjimit publik për Draft- Planin Lokal të Veprimit në Mjedis. Dëgjimi Publik i lartcekur është organizuar për t’u mbajtur me datën 08.07.2021, në ora 14:00, në Sallën e Kuvendit Komunal. Në këtë datë i gjithë ekipi përgjegjës ishte prezent në Sallën e Kuvendit me prezantimet e nevojshme të draftit - Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, mirëpo nuk kishte qytetarë prezent në takim.

Njëkohësisht të gjithë qytetarët dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 14 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i jepnin edhe përmes ueb faqes së Komunës dhe emailit zyrtar të zyrtarit përgjegjës.

Të pranishëm në takim nuk kanë qenë qytetarët, por përmes emailit kanë dërguar komentet e tyre 5 qytetarë.

Me respekt!
Bashkangjitur mund të gjeni :
Raportin dhe listën e email-ve

RAPORT

Duke u bazuar në afatet ligjore që dalin nga Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, është organizuar mbajtja e diskutimit publik në Sallën e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës **me dt. 08.07.2021** duke filluar nga ora **14:00**, ku stafi përgjegjës ishte prezent dhe i përgatitur me prezantimin si dhe draftin e PLVM-së, mirëpo nuk kishte qytetar prezent. Por sa i përket diskutimit publik komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet e tyre qytetarët kanë shfrytëzuar mundësinë që përmes komunikimit me e-mail tek zyrtari përgjegjës z. Irfan Peci (email: irfan.peci@rks-gov.net), janë pranuar disa komente dhe sugjerime, si vijon:

1. artani93@hotmail.com (dt.29.06.2021) - Pasi e lexova Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, nuk e pash nëse e keni paraparë që të shpërndani kontejnerë shtëpiak të plastikes 120 litërshe, pasi që në shumë zona nuk keni shpërndare ende, siç është Vaganica. Andaj propozoj që të përfshihet ky projekt për ndarjen e kontejnerëve familjar për të gjithë qytetarët.
2. beqiri.milaim2017@gmail.com (dt.08.07.2021) - Në kuadër të projekteve prioritare të futet edhe projekti për përmirësimin e pikave për grumbullimin e mbeturinave, ku janë të vendosura kontejnerët, pasi që janë të dëmtuara, si dhe të bëhet monitorimi i mbeturinave mjekësore (si po grumbullohen, sterilizimi, grupimi etj.).
3. puki_81@hotmail.com- (dt.08.07.2021) - Sa i përket këtij Plani Lokal të Veprimit në Mjedis, unë mendoj se vetëdijësimi duhet të jetë prioritet. Që qytetarët të mos hedhin mbeturina.
4. xhelal.shabani12@hotmail.com- (dt.06.07.2021) - Unë rekomandoj që në kuadër të PLVM-së të përfshihet instalimi i sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit në disa lokacione në mënyre që të kemi të dhëna të sakta.
5. bone_v85@hotmail.com- (dt.08.07.2021) - Ju sugjeroj që në draftin e këtij Planit Lokal për Veprim në Mjedis të përfshihen krijimi i parqeve në qytet, sepse ka mungesë të madhe të parqeve sidomos Ilirida dhe lagje tjera.

Të gjitha këto rekomandime do të merren parasysh dhe janë të inkuorporuar në draftin final i cili do të procedohet në Kuvendin e Komunës për miratim.

Me respekt,

